

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË
"CIRCULAR +" shpk**

Ne mbështetje të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "**Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare**", vendosa hartimin e këtij Akti Themelimi, me kushtet që përcaktohen si më poshtë:

Sot ne date 01/11/2025, ortakët:

Znj. Viola Allka, e lindur në Tepelenë më datë 02.09.1987, e identifikuar me Letërnjoftimin ID të lëshuar nga autoritetet shqiptare me nr. I75902024Q e vlefshme deri më datë 14.02.2031

Elba Xhebro, e lindur në Tepelenë më datë 01.01.1997, e identifikuar me Letërnjoftimin ID të lëshuar nga autoritetet shqiptare me nr. J75101041B e vlefshme deri më datë 25.02.2035.

me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, të shprehur nëpërmjet këtij akti themelimi, vendosi për krijimin e shoqërisë tregtare "**CIRCULAR +" SH.P.K.** me kushtet e mëposhtme:

Neni 1- Emërtimi

Shoqëria Tregtare do të ketë Emërtimin "**CIRCULAR +" SH.P.K.**

Neni 2- Forma juridike

Shoqëria Tregtare "**CIRCULAR +" SH.P.K.**", themelohet si Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar. Shoqëria është Person Juridik Privat Shqipëtar. Shoqëria krijohet në bazë të Ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ku ne nenin 3 përcaktohet se:

"1. Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomike të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik (shoqëritë me ortak apo aksionar të vetëm).

2. Shoqëritë tregtare duhet të regjistrohen sipas nenit 22 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", si dhe neneve në vijim, sipas formës përkatëse të shoqërisë tregtare.

3. Shoqëritë tregtare fitojnë personalitetin juridik në datën kur kryhet regjistrimi i tyre në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Shoqëritë përgjigjen me të gjitha aktivet e tyre për detyrimet, që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara."

Neni 3- Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë "**CIRCULAR +" SH.P.K.** do të vazhdojë veprimtarinë e saj me një afat kohor të pakufizuar.

Shpërndarja ose prishja e shoqërise mund të behet ne cdo kohë:

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

b) me vendim të ortakëve;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtësën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pasprishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues

Neni 4- Selia

Shoqëria "**CIRCULAR +**" **SH.P.K.** e ka selinë në adresën Rr. 'Medar Shtylla', Ndërtesa 1845, Hyrja 1, Apartamenti 143, Tiranë.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hap zyra perfaqësie, degë, të krijoj filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, me vendim asambleje të Ortakëve.

Neni 5- Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Ndërmjetësim midis shitësve dhe blerësve përmes një platforme e-commerce për shkëmbimin e mallrave të dorës së dytë, tekstileve, veshjeve, këpucëve dhe artikujve të tjerë. Subjekti do të angazhohet në të gjitha llojet e aktiviteteve që synojnë rritjen e aktivitetit parësor, përfshirë promovimin, menaxhimin dhe zhvillimin e mundësive të reja tregtare në sektorët përkatës.

Neni 6 - Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është i perberë nga kontributi i ortakëve themelues me vlerën 10,000 lekë, dhe përbëhet tërësisht nga kapitali në para. Një kuote përveç vlerës nominale të saj, ka edhe vlerën e një vote në mbledhjen e asamblesë së ortakëve.

Ne momentin e krijimit të shoqërise, Kapitali themeltar prej 10,000 lekë, është paguar tërësisht nga ortakët themelues. Në bazë të kontributit të paguar pjesmarrja e ortakëve në kapitalin themeltarë është;

- Viola Allka me 50% të kapitalit.
- Elba Xhebro me 50% të kapitalit.

Neni 7 TRANSFERIMI I KUOTEVE

Kuotat e kapitalit janë lirisht të Transferueshme ndërmjet Ortakëve. Ortaku që kërkon të shes kuotën e tij një personi të tretë, duhet detyrimisht të njoftoj ortakëve të shoqërisë blerjen e kuotave të tij në të njëjtat kushte si personit të tretë të cilit ai dëshiron t'ia shes. Kur disa ortakë ushtrojnë të drejtën e tyre të parablerjes dhe shprehin dëshirën e tyre për të blerë kuotën, ortaku shitës gëzon të drejtën diskrecionale për të zgjedhur se cilit ortak ai dëshiron të shes totalisht ose pjesërisht kuotat e tij. Ortakët duhet të përgjigjen brenda 30 ditëve nëse dëshirojnë të blejnë kuotat e ofruara apo jo.

Neni 8 SHPERNDARJA E FITIMIT

Ortakët financojnë, përfitojnë rimbursim të financimit të tyre dhe ndajnë fitimin e tyre në baze të kuotave në kapitalin themeltar.

Neni 9 ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Organet Drejtuese të Shoqërisë janë:

1. Administratori,
2. Asambleja e Ortakëve.

Administrator i Shoqërisë është **Elba Xhebro**, i datëlindjes 01.01.1997, lindur në Tepelenë, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar me letërnjoftimin me nr. J75101041B, me datë lëshimi 26.02.2025.

Neni 10

Asambleja e ortakëve

Asambleja e ortakëve mund të zhvillohet me pjesëmarrjen e personave në vende të ndryshme, të lidhur me instrumente e mjete të telekomunikacionit, në përputhje me metodat normale të telekomunikimit, duke përfshirë këtu mënyrën elektronike, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit, që marrin pjesë në telekonferencë dhe/ose video-konferencë dhe/ose me mënyra të ngjashme elektronike, të mund të identifikohen dhe t'u jepet atyre mundësia

të kryejnë e të marrin pjesë në diskutime, të marrin, dërgojnë dhe vlerësojnë dokumentacionin e përdorur gjatë mbledhjes.

Neni 11 - Administrimi

Shoqëria mund të administrohet nga një Administrator i Vetëm ose nga dy a më shumë Administratorë, të cilët ushtrojnë të drejtat e dhëna atyre së bashku apo më vete.

Asambleja zgjedh sistemin e administrimit dhe në rast se ka më shumë administratorë, cakton numrin e tyre, që nuk duhet të kalojë pesën, si dhe të drejtat përkatëse.

Administratorët e shoqërisë mund të mos jenë ortakë dhe janë të rizgjedhshëm. Kohëzgjatja e tyre në detyrë për një kohë të pakufizuar, deri në revokim apo dorëheqje, ose për një periudhë të caktuar herë pas here bëhet nga asambleja e ortakëve.

Neni 12- Kompetencat e administratorit

Administratori ushtron kompetenca ne emer te Shoqërisë:

- kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatis dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare; Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut te vetem edhe ne rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,
- Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve te shoqërisë.

[Signature] 4

- d) Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Neni 13

Veprimtaria ekonomike dhe financiare e shoqërisë ndahet në periudha financiare 12 mujore. Viti financiar fillon nga data 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të cdo viti kalendarik, me përjashtim të vitit të parë i cili fillon nga data e krijimit të shoqërisë dhe mbaron më 31 Dhjetor.

Neni 14

Shoqëria mban dokumentacionin e nevojshëm financiar për administrimin e pasurisë dhe për zhvillimin e të gjithë veprimtarisë së saj, në përputhje me kërkesat e të gjithë legjislacionit përkatës në fuqi.

Bilanci financiar i shoqërisë përpilohet në bazë të raportit me shkrim të ekspertëve kontabël të autorizuar dhe të raportit të paraqitur nga administratorët brenda dates 31 mars të vitit pasardhës. Të dy raportet paraqiten dhe miratohen në asamblenë e ortakëve brenda dates 30 qershor.

Fitimi neto i shoqërisë llogaritet mbasi zbriten humbjet e mundeshme të vitit të mëparshëm, shlyerja e të gjitha detyrimeve fiskale dhe ndaj cdo personi të tretë, si dhe fondet financiare që përbejnë rezervën e detyrueshme.

Neni 15- Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Mosmarrveshjet lidhur me themelimin dhe zhvillimin e veprimtarisë së shoqërisë zgjidhen nga vetë ortakët e shoqërisë me mirëkuptim, dhe kur kjo nuk arrihet ato zgjidhen nga gjykata në territorin e së cilës ndodhet selia e shoqërisë.

Neni 16

Ky Akt Themelimi u hartua në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën Shqipe.

ORTAKËT E SHOQËRISË "CIRCULAR +" shpk

Viola Alho

Elba Xhebo